

**U prezantua udhëzuesi “Fëmijët në konflikt me ligjin” dhe u ndanë diplomat për edukatorët bashkëmohatarë në fushën e parandalimit të narkomanisë**

# Partnerë për parandalim

**“Të gjithë jemi përgjegjës për krijimin e mundësive të bukura për të rinjtë në shoqërinë tonë dhe se bashkëpunimi cilësor i sektorit civil me qeverisjen lokale mund të ndikojë fuqishëm në parandalimin e drogës tek të rinjtë, duke i udhëzuar ata në SHBA-së, Margaret Uyehara**



Ulqin – Organizata e Shoqërisë Civile “Horizonti i Ri” organizoi të enjten në Bibliotekën e Ulqinit aktivitetin ku u prezantua udhëzuesi “Fëmijët në konflikt me ligjin” dhe u ndanë diplomat për edukatorët bashkëmohatarë në fushën e parandalimit të narkomanisë.

Në këtë ceremoni, përveç drejtuesve më të lartë të Komunës së Ulqinit dhe institucioneve shtetërore që veprojnë në nivelin lokal, ishte e pranishme edhe Ambasadorja e SHBA-së, Margaret Uyehara.

Në fjalën e saj, mes tjerash ajo theksoi se “të gjithë jemi përgjegjës për krijimin e mundësive të bukura për të rinjtë në shoqërinë tonë dhe se bashkëpunimi cilësor i sektorit civil me qeverisjen lokale mund të ndikojë fuqishëm në parandalimin e drogës tek të rinjtë, duke i udhëzuar ata në rrugën e duhur”. Ambasadorja Uyehara vlerësoi lart punën e “Horizontit të Ri”, të cilët për tre muaj me radhë organizuan trajnimin e një grupi të të rinjve nga Ulqini, të cilët tani mbajnë titullin e edukatorit bashkëmohatar.

“Drogat ndikojnë në jetën e miliona njerëzve në mbarë botën dhe për këtë jam shumë e lumtur që Ambasada Amerikane e mbështet këtë projekt financiarisht”, theksoi ajo.

Kryetari i Komunës së Ulqinit, Nazif Cungu, ka thënë se qeverisja lokale përmes Zyrës për Parandalimin e Narkomanisë, në mënyrë aktive merr pjesë në luftën kundër fenomenit të narkomanisë në qytet.

Ai e vlerësoi rolin e OJQ-ve lokale për kontributin e rëndësishëm në hartimin e politikave lokale dhe tha se Komuna vazhdimisht mbështet iniciativat e shoqërisë civile, duke forcuar kështu partneritetin e ndërsjellët në dobi të komunitetit lokal.

Kryetari i Gjykatës Themelore në Ulqin, Amir Gjokaj, vlerësoi se është prioritet i secilit komunitet që të veprojë në mënyrë parandaluese dhe të luftojë përdorimin e narkotikëve, sepse siç tha ai, narkomania së pari paraqitet si problem individual, pastaj si problem familjar dhe në fund si problem i komunitetit dhe tërë shoqërisë.

Shefi i Policisë së Ulqinit, Sead Gjozoviç, vlerësoi se në zgjidhjen e problemit të narkomanisë duhet të përfshihen të gjitha institucionet e sistemit.

Drejtori i Qendrës për Punë Sociale në Ulqin, Mehmet Duraku, u fokusua në rëndësinë e informacionit që jep Udhëzuesi për të drejtat e fëmijëve, për legjislacionin vendas dhe konventat ndërkombëtare që e trajtojnë këtë

fushë, duke theksuar se bashkëpunimi ndërsektorial është më se i nevojshëm për krijimin e shërbimeve të reja sociale në komunitet.

Psikologja Ardita Kovaçi, e cila ishte edhe trajnere e programit edukativ për të rinjtë e Ulqinit, vlerësoi nevojën e identifikimit të faktorëve rrezikues dhe mbrojtës që mund t’i shtyjnë ose t’i parandalojnë adoleshentët nga ndikimet negative të shoqërisë, duke konstatuar se projekti ia ka arritur këtij qëllimi.

Aktiviteti u realizua me moton “Partnerë për parandalim” duke ilustruar me këtë Rrjetin e partnerëve lokalë të krijuar në kuadër të këtij projekti e të cilin e përbëjnë: Komuna e Ulqinit, Gjykata Themelore në Ulqin, Prokuroria e Shtetit në Ulqin, Qendra për Punë Sociale në Ulqin, Zyra e Policisë në Ulqin, Shtëpia e Shëndetit në Ulqin dhe OJQ “Horizonti i Ri”.

Aktiviteti u zhvillua si pjesë e projektit “Partneriteti lokal në luftën kundër abuzimit me droga dhe delikucencës së të miturve”, të cilin OJQ “Horizonti i Ri” e realizon me mbështetjen e Ambasadës Amerikane në Podgoricë, përmes Zyrës për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit.

**(Kohapress)**